

## UDHËZIMI PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A2

### I. TË PËRGJITHSHME

1. Përcaktimi i fituesve ndërmjet maturantëve/kandidatëve për studime universitare të ciklit të parë, në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik (IALP), sipas parimit Meritë – Preferencë, bëhet si më poshtë vijon:
  - i. Parimi i meritës përcaktohet sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore (të detyruara dhe me zgjedhje) dhe për programe studimi të caktuara, edhe sipas rezultateve të arritura në konkurs (shih pikën 2).
  - ii. Parimi i preferencës përcaktohet nga vullneti i kandidatëve, i shprehur nëpërmjet jo më shumë se 10 preferencave të zgjedhura prej tyre.

#### **Shënim:**

Maturanti mund të arrijë nivelin e fituesit në disa programe studimi të përzgjedhura prej tij, por sistemi e shpall atë fitues në preferencën më të lartë (të sipërme) të shprehur prej tij. Kjo është arsyeja që në plotësimin e formularit A2 është shumë e rëndësishme jo vetëm përzgjedhja e programeve të studimit (preferencat) por dhe renditja e tyre.

2. Të gjitha programet e studimit të Universitetit të Arteve dhe të Universitetit të Sporteve të Tiranës, programet "Edukim Fizik dhe Sporte" të Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër, programi i studimit "Edukim Fizik dhe Sporte" të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, programet e studimit të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, u nënshtrohen konkurseve të pranimit, të organizuar nga këto Institucione Publike të Arsimit të Lartë në datat e përcaktuara në udhëzimin përkatës për zhvillimin e konkurseve.

**Vëmë në dukje se konkursi për programet e studimit të FASTIP (Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu") zhvillohet për njohuritë në gjuhën angleze si dhe intervistë nga kompania që mbështet praktikën profesionale të kandidatit.**

Për këto programe studimi në procesin e llogaritjes së pikëve të maturantit kandidat merren parasysh dhe rezultatet e konkurseve të pranimit.

3. Për të fituar të drejtën e studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik (IALP) të vendit, çdo maturant që kërkon të vazhdojë studimet e larta, **duhet të plotësojë Formularin A2, on-line** në çdo mjedis ku ka akses interneti.


Për plotësimin e tij online do të veprohet si më poshtë vijon:

Secili maturant/kandidat që ka kryer pagesën për aplikimin me formularin A2 në zyrat e Postës Shqiptare apo në secilën bankë të nivelit të dytë, ka dorëzuar në shkollën e tij mandat pagesën përkatëse, mund të aplikojë nga çdo mjedis ku ka akses interneti, shkollë, zyrë, shtëpi, kafe internet, etj.

Për të hyrë në portalin e Maturës Shtetërore adresa që duhet përdorur është si më poshtë:

[matura.akp.gov.al](http://matura.akp.gov.al)

Fillimisht na shfaqet faqja kryesore e portalit si më poshtë:



The screenshot shows the homepage of the Matura Shtetërore website. The browser address bar displays 'matura.akp.gov.al/site/'. The page features a navigation menu with links for 'KRYESORE', 'MATURA', 'UDHËZIME DHE FORMULARË', 'PROGRAME ORIENTUESE', and 'TESTE PËRGATITORE'. The main content area is titled 'FAQJA KRYESORE PËR MATURËN SHTETËRORE' and includes a search bar, a 'Kontrolloni notat, shikoni ecurine e aplikimit tuaj.' section with an 'Identifikohuni' button, and a 'Materiale të dobishme' section with a link to 'Tabela e pikeve te fituesit te fundit per vitet 2007-2011'. A central text block states 'Mund të përzgjidhni materiale të përgjithshme nga menutë, apo të dhënat tuaja specifike nëse hyni në sistem duke vendosur të dhënat tuaja.' and includes an 'Apliko' button. The footer of the page contains the text 'Për të aplikuar me formularin A2 klikoni tek butoni i mëposhtem' and another 'Apliko' button.

Maturanti/kandidati klikon te butoni **Apliko** në pjesën qendrore të dritares dialoguese . Pas këtij veprimi na shfaqet dritarja e mëposhtme:

ID e Maturantit	<input type="text"/>
Emri	<input type="text"/>
Atësia	<input type="text"/>
Mbiemri	<input type="text"/>
Karte Identiteti - <a href="#">Shembull</a>	<input type="text"/>
Email i Maturantit	<input type="text"/>

Te fushat e shfaqura duhet të plotësohen të dhënat e kërkuara duke patur kujdes. Në fushën **"Karta e Identitetit"** duhet të vendoset **numri personal** (kliko mbi fjalën shembull dhe do të shfaqet një kartë identiteti ilustruese. Numri personal i kartës, i kornizuar si më poshtë, gjëndet në pjesën e poshtme në të djathtë të saj).



Pasi të keni plotësuar fushat e mësipërme, duhet bërë kujdes që informacioni të jetë i saktë sepse përdoret për verifikime të mëvonshme. Pas kësaj klikoni te butoni

ID e Maturantit	<input type="text" value="130100100066"/>
Emri	<input type="text" value="Alban"/>
Atësia	<input type="text" value="Gëzim"/>
Mbiemri	<input type="text" value="Hafizi"/>
Karte Identiteti - <a href="#">Shembull</a>	<input type="text" value="B1211112W"/>
Email i Maturantit	<input type="text" value="albanhafizi@yahoo.com"/>

Nëse të dhënat tuaja nuk janë të sakta do të shfaqet mesazhi i mëposhtëm:

ID e Maturantit	130100100066
Emri	Alban
Atësia	Gëzim
Mbiemri	Hafizi
Karte Identiteti - <b>Shembull</b>	J10203540W
Email i Maturantit	albanhafizi@yahoo.com

**Maturanti nuk perkon me karten e identitetit**

**Identifikohu**

Fillimisht kontrolloni edhe njëherë saktësinë e të dhënave që keni shkruar dhe klikoni përsëri te butoni **Identifikohu**. Nëse ju shfaqet përsëri i njëjti mesazh, kjo do të thotë se për të bërë aplikimin online ju duhet të paraqiteni detyrimisht pranë Drejtorisë/Zyrës Arsimore të rrethit tuaj me dokumentin tuaj personal të identifikimit për të kryer aplikimin nën kujdesin e përfaqësuesit të Drejtorisë.

Nëse të dhënat tuaja janë të sakta do të vazhdoni procedurat e aplikimit online sipas hapave të mëposhtme.

Pas klikimit të butonit **Identifikohu** shfaqen dritaret e mëposhtme sipas rastit:

**Rasti I** Maturanti/kandidati nuk ka kryer pagesën dhe për rrjedhojë nuk i ka të hedhura në sistem pikët/notën mesatare

**MATURA SHTETËRORE**  
Agjencia Kombëtare e Provimeve

KRYESORE MATURA UDHËZIME DHE FORMULARË PROGRAME ORIENTUESE TESTE PËRGATITTORE VITET MË PARË

Perdoruesi: 130100100041 | | [Ndrysho fjalëkalim](#)

Menu  
Gjeneralitete të Studentit  
Notat e Provimeve

**Ju nuk keni note mesatare!**

### Formulari A2


<b>Emri</b> Sami	<b>Vendlindja</b> Berat	<b>Nota Mesatare</b>	<b>E pa disponueshme.</b>
<b>Atësia</b> Agim	<b>Shkolla e Mesme</b> (1) AJETXHINDOLE, BERAT	<b>GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI PROFESIONALE</b>	4.84
<b>Mbiemri</b> Mata	<b>Profili</b> SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE	<b>MATEMATIKË, PROFESIONALE</b>	5.09
<b>Gjinia</b> Mashkull		<b>QYTETARI</b>	5.32
<b>Datelindja</b> 06/09/1994		<b>HISTORI MUZIKE</b>	6.00

**Programe Studimi dhe Piket Minimale nga 3 Vitet e Kaluara:**


**Ju nuk keni perzgjedhur asnje program studimi akoma.**

Maturanti nuk mund të aplikojë për formularin A2 sepse në sistemin informatik nuk ka të pasqyruar notën mesatare.

## Rasti II. Maturanti/kandidati e ka kryer pagesën dhe i ka të hedhura në sistem pikët/notën mesatare.



MATURA SHITETËRORE  
Agjensia Kombëtare e Provimeve



KRYESORE MATURA UDHËZIME DHE FORMULARË PROGRAME ORIENTUESE TESTE PËRGATITORE VITET MË PARË

Perdoruesi: 130100100066 || Ndrysho fjalikalim

Menu  
Gjeneralitete të Studentit  
Notat e Provimeve

### Formulari A2

<b>Emri</b> Alban	<b>Vendlindja</b> Berat	<b>Nota Mesatare</b>	8.14
<b>Atësia</b> Gezim	<b>Shkolla e Mesme</b> (1) AJETXHINDOLE, BERAT	<b>GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI PROFESIONALE</b>	5.23
<b>Mbiemri</b> Hafizi	<b>Profili</b> SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE	<b>MATEMATIKË, PROFESIONALE</b>	5.22
<b>Gjinia</b> M		<b>QYTETARI</b>	7.95
<b>Datelindja</b> 11/12/1993		<b>HISTORI ARTI</b>	6.50

**Programet Studimi dhe Piket Minimale nga 3 Vitet e Kaluara:**

-- Zgjidh --

[+] Përzgjidhe Programin

Ju nuk keni përzgjedhur asnjë program studimi akoma.

Dergoje Formularin

- Në pjesën e sipërme maturantit i shfaqen të gjitha gjeneralitetet, pikët/nota mesatare e shkollës së mesme si dhe notat e marra gjatë provimeve të Maturës Shtetërore, të cilat duhet t'i kontrollojë me kujdes, dhe të mbajë shënime nëse konstaton pasaktësi në të dhënat tija dhe të vazhdojë aplikimin.
- Çdo maturanti, pas daljes së Librit të Transparencës, i vihet në dispozicion formulari i korigjimit të pasaktësive, i cili publikohet në faqen zyrtare të AKP-së ([www.akp.gov.al](http://www.akp.gov.al)). Pas shkarkimit dhe printimit të tij, maturanti/kandidati evidenton gabimet e konstatuara në të dhënat e tij. Këtë formular pas korigjimit të pasaktësive në të dhënat personale, ai duhet ta dorëzojë në shkollën ku ka bërë aplikimin me formularët A1 ose A1Z. Këtë të fundit, drejtoritë apo zyrat arsimore rajonale e përcjellin në AKP, e cila nga ana e saj ka detyrë të verifikojë saktësinë dhe të kryejë korigjimet duhura në sistem.
- Poshtë të dhënave personale të maturantit është një Drop Down List e cila i jep mundësinë atij që të përzgjedhë njërin nga programet e studimit që ofrohen nga IALP-të për vitin akademik të ardhshëm 2014-2015.
- Pas përzgjedhjes, më poshtë, shfaqen pikët që maturanti grumbullon në këtë program studimi dhe pikët e fituesit të fundit të fazës së dytë në vitin akademik 2013 - 2014. Duke i krahasuar pikët e grumbulluara me ato të vitit të kaluar, maturanti mund të marrë vendim që ta përzgjedhë ose jo atë program studimi. Për ta përzgjedhur një program studimi ai duhet të klikojë mbi butonin **Përzgjidhe Programin**.
- Sistemi informatik nuk të lejon që të përzgjidhem më shumë se 10 preferenca, por lejon që të fshihet ndonjëra prej tyre si dhe të rirenditen ato. Nëse duhet të heqim një program studimi mjafton të klikojmë tek butoni "**Hiqe**" ndërsa për t'i rirenditur, në kutizat anësore duhet të shtypim renditjen e re të propozuar dhe më pas klikojmë mbi butonin poshtë "**Ruaj Renditjen**" (**Kujdes!** Gjatë vendosjes së renditjes së re nuk duhet të kemi përsëritje numrash)

Program e Studimi dhe Piket Minimale nga 3 Vitet e Kaluara:

181 - UNIVERSITETI I VLORËS "Ismail Qemali" - Inxhinieri Mekanike

[+] Perzgjidhe Programin

Preferenca	Programi i Studimit	Kodi	Universiteti	
1	Hiqe	Inxhinieri Mekanike	181	UNIVERSITETI I VLORËS "Ismail Qemali"
2	Hiqe	Ekonomiks i Aplikuar	050	UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
3	Hiqe	Mësuesi për Arsimin Fillor	191	UNIVERSITETI I VLORËS "Ismail Qemali"
4	Hiqe	Gjermanisht-Englisht	234	UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu"
5	Hiqe	Shkenca Politike	028	UNIVERSITETI I TIRANËS

Ruaj Renditjen

Dergoje Formularin

- Theksojmë edhe njëherë se për suksesin e aplikimit me formularin A2 janë të rëndësishme jo vetëm programet e studimit të përzgjedhura, por dhe renditja e tyre.
- Pas përzgjedhjes të programeve të studimit të preferuara maturanti/kandidati klikon mbi butonin **“Dërgoje Formularin”**.
- Pas këtij hapi shfaqet një dritare tjetër dialoguese e cila i jep mundësinë maturantit të bëjë konvertimin e formularit të tij A2 në formatin PDF. Për konvertimin dhe printimin e Formularit A2 maturanti duhet të lexojë udhëzimet në fillim të dritares dialoguese.

Te dhënat u ruajtën me sukses.

## Sukses

Plotësimi i formularit u krye me sukses, dhe të dhënat janë ruajtur ne sistem. **Kthehu prapa** për të bërë korigjime.

Ju lutemi të printoni kopjen tuaj më poshtë.

1. Hapni menunë më poshtë.

2. Eksportoni në PDF

3. Printoni PDF-në

4. Firmosni formularin

- i. Formulari A2 mund të printohet nga maturanti/kandidati nëse dëshiron të ketë një kopje në letër të preferencave të përzgjedhura. Vëmë në dukje se printimi i formularit nga maturanti/kandidati nuk është i detyrueshëm. Për shtypjen në letër të formularit A2 ndiqen hapat e mëposhtme:
- j. Fillimisht eksportojmë formularin A2 në formatin PDF si më poshtë:

## Printoni Formularin




MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE (AKP)

**A2 PRANIMET 2014 NË ARSIMIN E LARTË** përmes parimit Meritë - Preferencë

Emri:	Alban	Gjinia:	Mashkull	Shkolla:	(1) A-JET XHINDOLE, BERAT
Atesia:	Gëzim	Vendlindja:	Berat	Profili:	SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE
Mbiemri:	Hafizi	Datelindja:	11/12/1993	Nota Mesatare:	8.14


RENDITJA	UNIVERSITETI	PROGRAMI I STUDIMIT
1	UNIVERSITETI I VLORËS "Ismail Qemali"	Inxhinieri Mekanike
2	UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	Ekonomiks i Aplikuar
3	UNIVERSITETI I VLORËS "Ismail Qemali"	Mësuesi për Arsimin Fillor
4	UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu"	Gjermanisht-Englisht
5	UNIVERSITETI I TIRANËS	Shkenca Politike

- k. Për të lexuar skedarët PDF mund të përdoren programet Adobe Reader ose Foxit Reader.



- l. Përzgjidhni opsionin **Open with** dhe më pas klikoni mbi butonin **OK**. Pasi hapet skedari maturanti mund ta printojë, nëse dëshiron, formularin e përzgjedhjeve të kryera nga vetë ai.





- m. Pasi maturanti ka printuar ose jo (sipas dëshirës) formularin e preferencave të tij, ai largohet nga Portali i Maturës Shtetërore duke klikuar mbi butonin **Dil** në pjesën e sipërme djathtas të dritares.

